LIGJ
Nr.8285, datë 16.2.1998

PËR "RATIFIKIMIN E LETRËS SË GARANCISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KUADRIN E MARRËVESHJES SË HUASË, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT ME KFW-NË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË UJËSJELLËSIT TË KORÇËS"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Letra e Garancisë, lëshuar nga Republika e Shqipërisë në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë, Financimit dhe Projektit me KFW-në për financimin e projektit të rehabilitimit të ujësjellësit të Korçës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1999, datë 20.2.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani